



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, nenit 40, paragrafi 40.2, pika **d** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391 të dt. 25.2.2010, dhe propozimit të Grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014, të dt. 6.2.2014, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.2.2014, miratoi

**PLANIN**  
**VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS**

**I.**

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014.

**II.**

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e Kuvendit të Komunës dhe pikat – temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

**III.**

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

**1. Mbledhja I, muaji janar:**

- Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
- Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Caktimi i Grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014;
- Propozimvendimi për zbatimin e Udhëzimit administrative nr. 16/2008, për pagesat e stafit politik në komuna.

**2. Mbledhja II, muaji shkurt:**

- Miratimi i planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014;
- Formimi i Komitetit për Komunitete;
- Formimi i Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Propozimvendim për shitjen e pronës së luajtshme të Komunës;
- Caktimi i Komisionit vlerësues, detyrat dhe përgjegjësitë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;

- Caktimi i anëtarëve në komisionet komunale të aksionarëve në ndërmarrjet publike lokale;
- Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë;
- Pikat e papërfunduara gjatë mandatit të kaluar.

### **3. Mbledhja III, muaji mars:**

- Formimi i komiteteve jo obliguese të Kuvendit të Komunës;
- Formimi i komiteteve konsultative;
- Bartja e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2013 në vitin 2014;
- Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës – Raporti përfundimtar përmbledhës buxhetor për vitin 2013;
- Shqyrtimi i raporteve të komisioneve komunale të aksionarëve të NPL - ve për vitin 2013;
- Informatë për sigurinë në shkollat e Komunës;
- Informatë për gjendjen e furnizimit me ujë (Kompania e ujësjellësit rajonal “Prishtina” SH.A.).

### **4. Mbledhja IV, muaji prill:**

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar – mars 2014;
- Miratimi i vendimit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës;
- Informatë për mbjelljet pranverore;
- Shqyrtimi i propozimrregulores për transportin lokal;
- Shqyrtimi i propozimrregullores për varreza dhe mirëmbajtja e tyre.

### **5. Mbledhja V, muaji maj:**

- Informatë për rendin dhe qetësinë në komunë (Policia e Kosovës);
- Informatë për gjendjen e furnizimit me ujë (Kompania e ujësjellësit rajonale “Prishtina” SH.A.);
- Shqyrtimi i projektakteve nga kompetenca e Kuvendit të Komunës.

### **6. Mbledhja VI, muaji qershor:**

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2014;
- Shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2015 – 2017;
- Informatë për gjendjen e gjelbërimit në komunë.
- Diskutimi për arsimin në Komunën e Prishtinës

### **7. Mbledhja VII, muaji korrik:**

- Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës;
- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën prill – qershor 2014;
- Informatë për përgatitjen e korrje-shirjeve për kulturat bujqësore – drithërat e bardha;
- Miratimi i akteve normative – harmonizimi i tyre me legjislacionin në fuqi nga fushat me kompetencë të pushtetit lokal.

## **8. Muaji gusht:**

### **Pushim**

## **9. Mbledhja VIII, muaji shtator:**

- Shqyrtimi i projektbuxhetit të Komunës për vitin 2015;
- Shqyrtimi i projektregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015;
- Shqyrtimi i projektregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2015;
- Informatë për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2013/2014 dhe fillimin e vitit shkollor 2014/2015;
- Informatë për përfundimin e procesit të korrje-shirjeve.

## **10. Mbledhja IX, muaji tetor:**

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën korrik - shtator 2014;
- Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
- Miratimi i akteve komunale në pajtim me obligimet e komunave që kanë ndaj ligjeve, akteve nënligjore dhe akteve të tjera që zbatohen në pushtetin lokal.

## **11. Mbledhja X, muaji nëntor:**

- Shqyrtimi i propozimakteve nga përgjegjësia e Kuvendit të Komunës;
- Caktimi i Grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015;
- Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror.

## **12. Mbledhja XI, muaji dhjetor:**

- Informatë për planin vjetor të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2015;
- Miratimi i planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015;
- Harmonizimi i akteve normative me legjislacionin në fuqi.

### **IV.**

Për zbatimin e pikës III të këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

### **V.**

Ky plan hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 020-50940, më 28.02.2014**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**

## **A r s y e t i m**

Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale, dhe në bazë të Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL – së, Kuvendi i Komunës nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 22.1.2014, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozimplanit të Kuvendit të Komunës për vitin 2014.

Grupi punues ka mbajtur takime më 3 dhe 6 shkurt 2014, dhe pas finalizimit të këtij propozimplanit, ai i është dërguar për shqyrtim Këshillit të Drejtorëve.

Këshilli i Drejtorëve, më 12.2.2014, e ka shqyrtuar propozimplanin vjetor të punës së Kuvendit dhe ai është propozuar t'i dërgohet në procedurë të mëtejme Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për miratim.